

J.M. COETZEE

I NGADALTI

Roman

Përktheu nga origjinali anglisht:
Myrteza Shini

Skanderbeg Books

Copyright © J.M. Coetzee, 2005

All rights are reserved by the Proprietor throughout the world.

By arrangement with Peter Lampack Agency, Inc. 551 Fifth Avenue,
Suite 1613, New York, NY 10176-0187 USA.

© në gjuhën shqipe, Skanderbeg Books, Tiranë 2007

Titulli i origjinalit: *Slow Man*

ISBN 978 99943 51 12 1

Koncepti grafik i tekstit: Skanderbeg Books

NJË

Goditja i vjen nga ana e djathtë, flakëruese, e beftë dhe therëse, si një shkarkesë elektrike, duke e shkulur atë nga biçikleta. “Qetësohu! “i thotë ai vetes teksa flatron nëpër ajër (*flatron nëpër ajër si pendë e lehtë!*) Dhe vërtet i ndien gjymtyrët t’i shtendosen. “Si një mace,” i thotë vetes, “rrokullisu, brof në këmbë dhe bëhu gati për atë që të pret.” Edhe fjala *i zhdërvjellët* fillon të përshenjet.

Por punët nuk shkojnë tamam kështu. Nga mosbindja e gjymtyrëve apo marramendja, cilado qoftë arsyeja (ai më shumë e dëgjon se sa e ndien përplasjen e kokës së tij me asfaltin, një zhurmë e largët, kumbuese, si një daulle), jo vetëm që nuk brof në këmbë, por, përkundrazi, rrokulliset metër pas metri, një copë herë, derisa më në fund gjen qetësinë.

Ai rri shtrirë gjerë gjatë, në prehje të plotë. Mëngjesi është i mrekullueshëm. Prekja e diellit është e ëmbël. Ka edhe më keq se lëshimi i vetes në pritje të rikthimit të fuqisë. Në fakt, mund t’i kishin ndodhur gjëra më të këqija se përgjumja. Ai mbyll sytë; bota i pirret nën këmbë, rrotullohet; ai humb ndjenjat.

Ai vjen në vete vetëm për një çast. Trupi që kishte flatruar si pendë nëpër ajër është bërë plumb i rëndë, aq i rëndë, sa nuk është në gjendje të lëvizë as edhe një gisht. Si nëpër mjegull dallon dikë sipër kokës, që i zë ajrin - një djalë me flokë të grathët dhe puçrra në ballë. “Biçikleta ime”, i thotë djaloshit, duke e shqiptuar fjalën e vështirë rrokje për rrokje. Dëshiron ta pyesë se ç’ bëhet me biçikletën, nëse po merret dikush me të, pasi dihet se një biçikletë mund të zhduket sa hap e mbyll sytë. Por humb sërish ndjenjat para se fjalët t’i dalin nga goja.

Luhatjet sa në njërën anë në tjetrën, i japin të kuptojë se po e transportojnë. Në vesh i mbërrijnë zëra nga larg. Bëhet një rrëmujë që mbaron ende pa filluar mirë. Çfarë po ndodh? Sikur të hapte sytë, do ta merrte vesh. Por është ende herët për këtë. Diçka do t'i ndodhë. Germë pas germe, *krak, krak, krak*, po shtypet një mesazh në ekranin ngjyrë trëndafili, që dridhet i tëri sa herë përpëlit sytë. Ka shumë të ngjarë të jetë pjesa e brendshme e kapakut të syrit. Germat formojnë E-R-T-Y, pastaj, I PAVLER-, pastaj një drithërimë, pastaj E, pastaj Q-W-E-R-T-Y, gjashtë gerrat e para në tastierë, e kështu me radhë.

I pavlerë. Atë e pushton një lloj tmerri. Përpëlitjet vazhdojnë; një psherëtimë i ngjitet nga përbrenda dhe shpërthen në të dalë të gurmazit.

“Të dhemb shumë?” i thotë një zë. “Mos lëviz !” E shpojnë me një gjilpërë. Dhimbja iu hoq si me dorë. Pas pak edhe tmerri. Më në fund vjen në vete.

Kur zgjohet e sheh veten në një kukule të mbushur me ajër pa jetë. Bën të ngrihet, por më kot, i duket sikur e kanë futur në beton. Përreth tij gjithçka është e bardhë: tavan i bardhë, çarçafë të bardhë, dritë e bardhë; një bardhësi grimcore si një pastë dhëmbësh bajate që duket sikur i ka veshur trurin, sikur i ka hequr kthjellësinë e mendimit. Kjo e dëshpëron së tepërmi. “Po kjo ç’është?” ngërdheshet ai, madje bërtet si për të thënë: *Çfarë më keni bërë kështu? Ku ndodhem? Ç’është kjo fatkeqësi që më ka gjetur?*

Krejt papritur shfaqet një grua e re e veshur me të bardha, e cila ndalon dhe e vështron atë gjithë vëmendje. Megjithë pështjellimin që ka në kokë, përpiqet të formojë një pyetje. Tepër vonë! Pas një buzëqeshjeje dhe prekjeje të lehtë në krah, që për çudi nuk e ndien, por e dëgjon, grua e vazhdon më tej.

Ka ndonjë gjë serioze? Po të kishte kohë për t’i bërë një pyetje, vetëm për këtë do ta kishte pyetur. Sa për kuptimin e fjalës serioze, nuk i pëlqen ta vrasë mendjen. Por edhe më urgjente se sa pyetja për seriozitetin e gjendjes, edhe më urgjente se sa pyetja enigmatike për ndodhinë në rrugën Magill që e solli në këtë vend pa jetë, është nevoja që ndien për të shkuar në

shtëpi, të mbyllet brenda dhe të rrijë pa siklet deri sa ta marrë përsëri veten.

Ai provon të prekë këmbën e djathtë, atë që vazhdon të dërgojë sinjale të turbullta dhe që tani është këmba e keqe, por dora nuk i bindet, asgjë nuk i bindet.

Rrobat e mia? Kjo është pyetje pa zarrar, ndoshta duhet bërë e para. *Ku i kam rrobat? Ku i kam rrobat dhe sa serioze është gjendja?*

Gruaja e re shfaqet sërish në fushëpamjen e tij. “Rrobat”, thotë ai, me një stërmundim të madh, duke ngritur vetullat sa mundet për të treguar nevojën e ngutshme që ka për to.

“Mos u bëj merak”, i përgjigjet gruaja e re me një tjetër buzëqeshje, një buzëqeshje thujse engjëllore. “Gjithçka është në rregull, i kemi siguruar të gjitha. Pas pak vjen dhe doktori.” Dhe vërtet nuk kalon as edhe një minutë kur shikon një burrë të ri që ka ndaluar pranë saj dhe po i pëshpërit në vesh. Me sa duket është doktori për të cilin ajo foli.

“Pol?” thotë doktori. “A më dëgjon? Mirë ma kanë dhënë emrin, Pol Reiment?”

“Po,” thotë ai me qetësi.

“Mirëdita, Pol. Duhet të ndihesh paksa turbullt tani. Kjo vjen nga doza e morfinës që të kemi dhënë. Pas pak do të jemi në sallën e operacionit. Ke marrë një goditje të fortë, nuk e di sa të kujtohet, dhe këmba duket mjaft keq. Duhet t’i hedhim një sy dhe të shikojmë se ç’pjesë mund të shpëtojmë.”

Ai harkon sërish vetullat. “Të shpëtoni?” pyet me mundim të madh.

“Ç’pjesë të këmbës të shpëtojmë?” përsërit doktori. “Do të na duhet t’ju amputojmë këmbën, por do të shpëtojmë sa të mundemi.”

Në këtë çast diçka duhet t’i ndodhë fytyrës së tij, sepse doktori bën një gjest të çuditshëm. Ai shtrin dorën, e vë mbi faqen e burrit të vjetër dhe nuk e lëviz prej aty për një copë herë. Ashtu siç do të kishte bërë një grua e dashuruar. Ky gjest e vë Polin në siklet, por tërheqja e kokës do të ishte e pahijshme.

“Do të ma besosh mua këtë punë?” pyet doktori. Ai mbyll sytë në heshtje.

“Në rregull.” Pastaj mendohet pak. “Nuk kemi zgjidhje tjetër Pol,” thotë doktori. “Kjo është një situatë pa mundësi zgjedhjeje. E kupton? Do të na lejosh të vazhdojmë? Nuk kam ndër mend të të kërkoj firmën, por a do të na lejosh të vazhdojmë më tej? Do të shpëtojmë sa më shumë të mundemi. Goditja ka

qenë e fortë dhe këmba është dëmtuar shumë. Madje tani për tani s'mund të them nëse do të arrijmë apo jo ta shpëtojmë gjurin, që bashkë me një pjesë të tibies, ka pësuar thyerje të rëndë.”

Dhe sikur ta dijë se po flitet për të, sikur këto fjalë të tmer-rshme ta kenë zgjuar nga gjumi i trazuar, këmba e djathtë i dërgon një vetëtimë dhimbjesh therëse. Pas një rënkimi të thellë, ai ndien gjakun t'i vërshojë në vesh.

”Në rregull”, thotë doktori i ri dhe e përkëdhel lehtë në faqe. “Tani duhet të fillojmë”.

Kur zgjohet e ndien veten shumë më mirë. Mendjen e ka të kthjellët, i është kthyer uni i tij i vjetër (*Jam qiqër!*, kështu mendon), edhe pse është aq i pafuqishëm sa gjumi mund ta këpusë nga çasti në çast. Këmba e goditur i duket gjigante, si këmbë elefanti, por dhimbje nuk ndien.

Hapet dera dhe brenda hyn infermierja, një fytyrë e re, e freskët. “Ndiheni më mirë?” pyet ajo duke shtuar me nxitim: “Mos u mundoni të më ktheni përgjigje. Pas pak do të vijë doktor Hanseni për të folur me ty. Ndërkohë na duhet të bëjmë diçka tjetër. A mund t'ju kërkoj që të mos lëvizni kur unë të...”

Ajo duhet t'i fusë një sondë, ndaj i kërkon të mos lëvizë. Sa e pështirë t'ia bësh këtë dikujt; prapë mirë që këtë po ia bën një e huaj. *Ja ku u katandiske! qorton ai veten. Ja ku u katandiske po ta lesh mendjen të të fluturojë qoftë edhe për një sekondë! Po biçikleta? Ç'është bërë me të? Po pazarin, si do ta bëj tani? Gjithë fajin e kam vetë që i rashë nga rruga Magill! Ai e mallkon rrugën Magill, megjithëse në fakt ka qaq e qaq vite që kalon andej me biçikletë pa i ndodhur asgjë e keqe.*

Gjëja e parë që duhet të bëjë doktor Hanseni, sapo të vijë, është një përshkrim i shkurtër dhe i përgjithshëm i gjendjes së tij; më pas të japë më shumë detaje për këmbën, disa të mira, disa jo dhe aq të mira.

Së pari, për sa i përket gjendjes së tij të përgjithshme, duke patur parasysh se çfarë mund t'i ndodhë trupit të njeriut kur goditet nga një makinë me shpejtësi, ai mund ta përgëzojë veten se gjendja nuk është serioze. Në fakt, gjendja e tij është aq larg të qenit serioze, sa mund ta quajë veten fatlum e të bekuar. Vërtet pësoi tronditje në tru, por shpëtoi falë kaskës që mbante në kokë. Megjithëse nuk ka shenja hemoragjie ce-

rebrale, mbajtja nën kontroll do të vazhdojë. Në sy të parë funksionet motorike duken të padëmtuar. Ç'është e vërteta, humbi pak gjak, por tashmë ia kanë zëvendësuar. Nofullën e ka ende të mpirë, por jo të thyer, thjesht i është lënduar. Gërvishtjet në shpinë e në krah duken më keq sesa janë në të vërtetë; për një ose dy javë do t'i jenë mbyllur.

Në lidhje me këmbën që mori goditjen, doli se ai (doktor Hanseni) dhe kolegët e tij nuk mundën t'ia shpëtonin gjurin. Pasi e kishin analizuar çështjen hollësisht, vendimi ishte marrë njëzëri. Goditjen e drejtpërdrejtë e kishte marrë në gju, si kurse do t'ia tregojë më vonë edhe radiografia. Kësaj iu shtua edhe rrokullisja, si pasojë nyja lidhëse u thye dhe u përdrodh njëkohësisht. Po të ishte një pacient më i ri në moshë, mbase do të kishin vendosur t'ia rregullonin, por kjo do të kërkonte një seri të tërë operacionesh, të njëpasnjëshëm, që do të zgjasnin për më shumë se një vit, ndoshta edhe dy, por me një garanci për sukses jo më shumë se pesëdhjetë përqind. Më në fund, duke marrë parasysh dhe moshën e tij, u mendua më mirë që t'i pritej këmba sipër gjurit, por të lihej gjatësi e mjaftueshme eshtre për protezë. Ai (doktor Hansen) shpreson se ai (Pol Reiment), me kalimin e kohës, do ta pranojë logjikën e këtij vendimi.

"Jam i sigurt që ke një mori pyetjesh," përfundon ai," dhe me kënaqësi do të përpiqem t'u përgjigjem, por ndoshta jo tani. E lemë më mirë për në mëngjes, kur të kesh pushuar disi."

"Protezë," thotë ai. Ja dhe një fjalë tjetër e vështirë, megjithëse tani që e mori vesh se nofullën nuk e ka thyer, por thjesht lënduar, edhe fjalët e vështira i shqipton më shkujdesur.

"Protezë. Këmbë artificiale. Sapo të shërohet plaga e operacionit, do të të vëmë një protezë. Pas katër javësh, ndoshta dhe më herët. Shumë shpejt do ta shohësh veten të ecësh sërish në këmbë. Do të ngasësh edhe biçikletën, po të duash. Gjithnjë pasi të kesh bërë disa seanca ushtrimore. Pyetje të tjera?"

Ai tund kokën. *Përse nuk më pyetët mua para se të merrnit vendimin?* Këto fjalë i ka në majë të gjuhës, por nëse i nxjerr nga goja, do të humbasë kontrollin, do të fillojë të bërtasë.

"Atëherë flasim nesër herët në mëngjes," i thotë doktor Hanseni. "Shtrëngohu dhe mos e lësho veten!"

Por kjo punë nuk mbyllet këtu. Nuk merr fund me kaq. Pas dhunimit vjen pranimi i dhunimit. Nuk e lënë të qetë pa nënshkruar më parë disa letra. Por për çudi dhe letrat na qenkan të vështira.

Familja, për shembull. Kush dhe ku janë familjarët, ka një pyetje në formular, dhe në ç'mënyrë do të njoftohen? Pastaj sigurimi. Te cila kompani është siguruar? Ç' lloj sigurimi ka?

Sigurimi nuk është problem për të. Ka sigurim të plotë, mund ta dëshmojë me kartën që ka në portofol, nuk bën shaka me këto gjëra ai (*po ku e ka portofolin, ku i ka rrobat?*). Kjo puna e familjes është disi e ngatërruar. Kush janë familjarët e tij? Cila është përgjigjja e saktë? Ai ka një motër. Motra ndërroi jetë para dymbëdhjetë vjetësh, por jeton ende brenda tij ose bashkë me të, ashtu sikurse ka një nënë, e cila kur nuk është brenda tij ose me të, pret joshjen e engjëjve në ngastrën e saj në varrezat e Ballaratit. Ka dhe një baba, që pret paksa më larg, në varrezat Pau, dhe që del rrallë për vizita. Kaq është familja e tij, këta të tre? *Ata që të sjellin në dritë nuk ndërrojnë jetë*, do të kishte patur dëshirë t'ia bënte të ditur atij që kishte formuluar këtë pyetje. *Njeriu i mbart ata me vete, ashtu siç shpreson edhe vetë që të mbartet prej pasardhësve*. Por në formular nuk ka vend për përgjigje të zgjeruara.

Në pikën tjetër ai mund të jetë shumë më i saktë, që nuk ka as grua, as pasardhës. Është e vërtetë se ka qenë i martuar njëherë; por bashkëshortja nuk është më me të. Ajo e braktisi, u largua përgjithnjë. Edhe sot e kësaj dite nuk e ka kuptuar marifetin që i bëri, por e vërteta është se ajo tashmë bën jetën e vet. Prandaj, për të qenë më praktik dhe natyrisht për të plotësuar dhe formularin, ai është i pamartuar: i pamartuar, beqar, i vetmuar, i vetëm.

Të afërm: ASNJË, shkruan ai me germa të mëdha nën mbiqyrjen e infermieres. Pyetjeve të tjera u heq vizë. Në fund i nënshkruan që të dy formularët. "Sa është data?" pyet infermieren. "Dy korrik," thotë ajo. Shënon edhe datën. Funksionet motorike të padëmtuara.

Ilaçet që pi, mendohet t'ia ulin dhimbjen dhe ta vënë në gjumë,

por ai nuk e mbyll syrin. Kjo nuk është aspak ëndërr, ky shtrat i çuditshëm, kjo dhomë e zhveshur, ky kundërmim ilaçesh dhe urine asfiksuese, kjo është e vërtetë, më e vërtetë s'ka si bëhet. Edhe pse e gjithë dita e sotme, nëse jemi në të njëjtën ditë, nëse koha ka ende ndonjë vlerë, të lë shijen e ëndrrës. Me siguri kjo gjëja poshtë çarçafit, të cilën vetëm tani e shikon me vërejtje, ky objekt monstruoz, i mbështjellë me fasha të bardha dhe i lidhur pas këllkut të tij, vjen drejtpër-

drejt nga vendi i ëndrrave. Po atë gjënë tjetër, atë gjënë për të cilën foli me aq entuziazëm ai burri i ri me ato syzat vezuluese, kur do ta sjellin? Deri tani nuk ka patur rast të shikojë nga afër ndonjë protezë. Tabloja që i vjen në mendje është një shtagë druri me gremç në majë si një fuzhnjë apo thithakë prej gome me tri këmbët të vogla. Surrealizëm i pastër. Vepër e Dalit.

Ai shtrin njërën dorë (tre gishtërinjtë në mes i ka të lidhur me fasha, është hera e parë që i vë re) dhe shtyp atë gjënë e bardhë.

Nuk ndien asgjë. Si të ishte një copë druri. Kjo është veçse një ëndërr, thotë ai me vete, dhe bie në gjumë të thellë.

“Sot do të ngrihem në këmbë dhe të ecim,” thotë doktor Hanseni. “Sot pasdite. Nuk do ecim shumë, vetëm disa hapa sa për të krijuar idenë. Unë dhe Elena do të jemi me ty.” Ai i bën shenjë me kokë infermieres. Infermiere Elenës. “Elenë, na cakto një vizitë tek ortopedi!”

“Sot nuk dua të eci,” thotë ai. Dalëngadalë po mësohet të flasë me dhëmbët kyçur. Nofullën e ka të copëtuar, por jo vetëm. Edhe dhëmballët në atë anë i janë liru, e ka të pamundur të përtypet.

“Nuk kam pse të ngutem. Nuk dua protezë.”

“Në rregull,” thotë doktor Hanseni. “Por nuk po flasim për protezë, është ende herët për këtë. Po flasim vetëm për rehabilitim, për hapin e parë të tij. Megjithatë nuk prish punë, mund të fillojmë dhe nesër apo pasnesër. Mjafton që ta shohësh se nuk është fundi i botës të humbësh njërën këmbë.”

“Më lejon ta them përsëri: *Nuk dua protezë.*”

Doktor Hanseni dhe Elena shkëmbejnë vështrimet me njëri-tjetrin.

“Meqë nuk dëshiron protezë, çfarë do të të pëlqente?”

“Do të më pëlqente të kujdesesha për veten”

“Në rregull, e mbyllim këtë bisedë, nuk do të të bëjmë asgjë me detyrim.”

Të premtoj. Tani a mundem të flas për këmbën? A mundem të të tregoj si të kujdesesh për këmbën tënde?”

Të kujdesem për këmbën time? Ai po merr flakë nga zemërimi- a është e mundur të mos e vënë re këtë? Ju më bëtë anestezi, më këputët këmbën dhe ma hodhët në kazanin e plehrave, nga ku mund ta marrë dikush e ta djegë në sobë. Si merrni guximin të më tregoni se si të kujdesem për këmbën time?



ShtepiaeLibrit.com

Libraria ime...

Si mund të porosisni libra nga ShtepiaeLibrit.com ?

Përshëndetje mik i librit!

Prej 3 vitesh, **ShtepiaeLibrit.com** shërben si një **librari virtuale** ku ju mund të **informoheni** dhe të **porosisni** libra direkt nga interneti.

Ne të specializuar në **promovimin, tregtimin** dhe **dërgimin** e librave shqip.

Ne dërgojmë porosi **në çdo vend të botës**, prandaj për të porositur libra mjafton të na jepni një **adresë të saktë postimi** dhe të **konfirmoni pagesën tuaj**. Më pas librat do t'ju vijnë me postë në adresën e porositur nga ju.

Aktualisht, **mënyrat kryesore të pagesës** për porositjen e librave janë këto:

1. duke paguar me **kartat e internetit: Visa, MasterCard, American Express** ose **Discover**
2. duke paguar me **PayPal.com** drejt adresës tonë: **sales@shtepiaelibrit.com**
3. duke i transferuar fondet në llogarinë tonë bankare në **Shqipëri** (ose në **Kosovë**)
4. duke i dërguar fondet nëpërmjet shërbimeve **Western Union, MoneyGram**, etj.

Pagesat mund të kryhen në **Euro, USD, Paund** dhe sigurisht **Lekë**. Porositë me **kartat e internetit** dhe me **PayPal** mund të kryen direkt nga faja jonë. Për **transfertat bankare** apo **dërgesat** me Western Union, MoneyGram, etj, ju lutem na kontaktoni paraprakisht me email që t'ju dërgojmë informacionet që do t'ju nevojiten.



Për klientët tanë nga **Shqipëria**, ne ofrojmë mundësinë e blerjes së librave **në lekë pranë librarisë tonë në Tiranë** (afër qendrës) ose **me pagesë bankare** brenda Shqipërisë. Postimi i librave brenda Shqipërisë bëhet **FALAS** nëse porosisni më shumë se një libër. Porositë brenda Tiranës mund t'i sjellim edhe dorazi.



Për klientët tanë nga **Kosova**, përveç pagesave nëpërmjet internetit ne ofrojmë edhe mundësinë e pagesës **me transfertë bankare në Euro**. Pagesat kryhen pranë **ProCredit Bank në Kosovë**. Librat ju vijnë me postë për 1 javë nga dita e pagesës.

Mirëpresim çdo pyetje apo kërkesë tjetër që mund të keni.

--

Elvisi & Gjergji

Administratorë

E-mail: admin@shtepiaelibrit.com **Tel.** +355 4 450 3262 **Mobile:** +355 68 60 52 510

Website: <http://www.ShtepiaeLibrit.com>

Adresa jonë: Libraria "Shtëpia e Librit"

Rruga e Barrikadave, Galeria Nasional (ish-Kinema 17 Nëntori), Kati I, Tirana, Albania.

